

## VËSHTRIME – REFLEKTIM PËR KULTURËN NË KOMUNIKACION

Publikuar në Koha ditore me dt. 06.10.2012

### Prindër, kujdes se si silleni në trafik

Të gjithë flasim pareshtur për mungesë kulturë varësisht se ku jemi. Mungesa e kulturës na rrethon gjithkrah, që nga shtëpia gjatë qëndrimit me familje dhe posa të dalim jashtë. Kësaj mungese të kulturës i kontribuojnë edhe mediet – këta “anëtarë” të rëndësishëm të familjeve tona – të cilat na bombardojnë me lajme të këqija: kronika të zeza, korrupsion, vjedhje, papunësi e pabesi, mungesë ligji, moszbatim ligji - dhe nga e gjithë kjo ne sikur harrojmë se ekziston diku shprehja kulturre.

Mungesa e kulturës reflekton çdo kund dhe në çdo kohë. Hajde së bashku, të paktën për një kohë të mundohemi të ndërrojmë qasjen dhe perceptimet për kulturën. Duke qenë se tash e njëzet vite në institucionin të cilin unë e drejtoj, merremi me edukimin, trajnimin dhe arsimimin e brezave të rinj, por jo vetëm ata, në fushën e komunikacionit, do të ndalem në mungesën e kulturës në trafik.

Sjellja jonë në komunikacion nuk është çdo herë në nivelin e duhur, pavarësisht se a jemi duke udhëtuar, ecur apo duke drejtuar veturën, biçikletën ose motorin.

Nuk mund të themi se gjatë kohës sa jemi në trafik nuk shohim sjellje të kulturuara, të shoferëve, udhëtarëve apo këmbësorëve. Nëse shikojmë me vëmendje sikur asnjëherë më parë respektohen këmbësorët në vendkalimet për këmbësorë, pati ose nuk pati sinjalizimin adekuat. Shumica e veturave që shfrytëzohen nga familjarët dhe kanë fëmijë të vegjël, i kane karriget adekuate për fëmijë. Shume rrallë ose asnjëherë nuk shohim që fëmijët të janë të ulur në karrigen e parë afër shoferit. Shoferët e veturave zakonisht afër hyrje-daljeve të shkollave janë më të kujdesshëm se sa në rrugët tjera të qytetit. Respektohen të moshuarit gjatë udhëtimit me autobus duke iu dhënë përparësi gjatë hyrjes ose daljes nga autobusi, por edhe duke i liruar ndonjë vend brenda në autobus. Për çdoherë e më tepër respektohen veturat e autoshkollave nga pjesëmarrësit tjerë në komunikacion kur ato janë me kandidatë. Gjatë parkimit të veturës kujdes i veçantë i kushtohet lënies së hapësirës se duhur për qarkullimin e veturave të tjera, ndonjëherë edhe ndihmohet ndonjë femër vozitëse për ta parkuar automobilin e vet.

Të gjitha veprimet në komunikacion janë të rregulluara me Ligj dhe nuk mund të themi se nuk ka ligj për çështje të caktuara, por mund të themi se nuk zbatohet ligji në çështje të caktuara. Sjellja e kulturuar në komunikacion e plotëson mungesën e zbatimit të ligjit. Jam i sigurt se me këtë vlerësim timin nuk do të pajtohej askush në shoqëritë ku në mënyrë absolute respektohet ligji. Në këto shoqëri nuk ka nevojë të bëhesh i mirë dhe i sjellshëm apo të tregosh kulturë në komunikacion, sepse ligji të detyron të bëhesh i mirë, i sjellshëm dhe në të njëjtën kohë edhe i kulturuar. Secili shofer në këto shoqëri, vetëm njëherë në jetën e tij mund të mos i jap përparësi këmbësorëve në vendkalimin e tyre. Duke paguar mjaftë mirë gjobën për kundërvajtjen e shkaktuar, ai asnjëherë në jetë nuk do të përsërisë këtë veprim. Ai nuk mund të mos e paguajë apo thjeshtë nuk guxon të mendojë për ta korruptuar policin ose të kërkojë të

`ngjofshëm` për t'ia hequr dënimin. Sjellja në komunikacion pa dyshim se është tregues mjaftë i mirë i kulturës të një shoqërie, por edhe sjellja në nivel e të gjithëve dhe qarkullimi i rregullt është po ashtu tregues i respektimit rregullave të komunikacionit dhe të dispozitave ligjore.

Gjatë pushimeve, sidomos muajve të verës kur rrugët tona vërshohen nga veturat e kurbetçinjve tanë të cilët vijnë në Kosovë, shpeshherë ndodhë që disa prej tyre të mos jenë shembull më i mirë për sjellje të përgjegjshme dhe të kulturuar në komunikacion. Ata vijnë nga shtetet ku në mënyrë absolute respektohet ligji, dhe sigurisht edhe ata janë respektuesit më të mëdhenj të ligjit në qytetet ku jetojnë dhe veprojnë. Asnjëherë nuk kam mundur të gjej përgjigjen për këto sjellje të dyfishta të disa nga këta shoferë, sjellja e të cilëve në qytetet ku punojnë dhe veprojnë është shembull për të mirë, ndërsa gjatë qëndrimit në Kosovë, sjellja e tyre në komunikacion është shembull për të keq. Disa nga këta shoferë përveçqë kanë shkaktuar aksidente në komunikacion, shpeshherë bëjnë edhe veprime të pahijshme në rrugë. Kombinimi më i mirë për një lëvizje të sigurt në komunikacion është që të respektohet ligji dhe secili pjesëmarrës të jetë i përgjegjshëm për sjelljen e vet. Sjellja e përgjegjshme tregon nivelin e kulturës dhe pa dyshim rrit sigurinë në komunikacion.

Shumë veta prej nesh kanë qenë në Shqipëri sidomos gjatë luftës në Kosovë. Sikur sot, të gjithëve na kujtohet mjaft mirë kaosi në të gjitha rrugët e Shqipërisë, sidomos nëpër mjediset urbane. Atëherë aspak nuk respektoheshin kodi dhe rregullat e qarkullimit rrugor, siç quhet në Shqipëri. Nuk ka pasur nevojë që gjatë drejtimit të veturës të përdorej treguesi për ndërrim të drejtimit, të respektohet shpejtësia e lëvizjes, të ndalesh apo veprosh sipas urdhrave të personit të autorizuar në rrugë, të shfrytëzosh përparësinë e kalimit etj. Të gjitha këto veprime janë rregulluar me bori. Kush e ka pasur borinë (sirenën) më të fortë ka qenë i pari. Viteve të fundit nuk kemi këtë pamje në rrugët e Shqipërisë, madje për dy arsye zbatimi i ligjit dhe sjellja e kulturuar në trafik. Të gjitha ato bori të dikurshme janë zëvendësuar me sinjalizim adekuat të rrugëve qoftë horizontal apo vertikal, respektohen personat e autorizuar të cilët rregullojnë komunikacionin, për çdo ditë e më tepër shohim vetura të reja nëpër rrugë.

Prindërit kanë një rol mjaft të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve për sjellje të sigurt në komunikacion. Dihet mirë se fatkeqësisht të në mungojnë programet e mirëfillta për kulturën në komunikacion në të gjitha nivelet e shkollimit. Pasi që fëmijët pothuajse nuk mësojnë asgjë në institucionet parashkollore dhe shkollore për sjelljen e tyre në trafik, atëherë kjo detyrë u takon prindërve. Secili prej nesh duhet të ketë kujdes se si sillet në çdo vend dhe në çdo kohë e posaçërisht në komunikacion. Fëmijët, në mungesë të të mësuarit për sjelljen e rregullt në trafik, ata do të mësohen nga ne. Dihet mirë se fëmijët janë kopjues mjaft të shkathët dhe veprimet tona të përditshme i regjistrojnë menjëherë. Shpeshherë ata në shkollë në shoqëri me moshatarët e tyre merren me këto çështje duke u lavdëruar se si babai i tyre e ka zgjidhur apo e ka marrë një veprim në komunikacion. Ata asnjëherë nuk vlerësojnë veprimet e marra, sepse çdo herë veprimet e marra nga prindërit për ata janë më të mirat dhe më të zgjuarat. "Heee, qysh e ka kaluar një automobil babi im, se veç ai di dhe mundet kështu!" Kjo është fjalia ndoshta më e dëgjuar në mesin e tyre.

Prindër, është shumë e dobishme që të bisedoni sa më shumë me fëmijët tuaj kur jeni duke

udhëtuar apo duke ecur. Shfrytëzojeni kohën për të komentuar dhe shpjeguar lidhur me sjelljen e drejtë dhe të sigurt në komunikacion. Secilin veprim të drejtë apo jo të drejtë të kuj do qoftë në trafik komentoni me fëmijën tuaj duke i dhënë shpjegimet adekuate për çështje të caktuara. Asnjëherë nuk është mjaft, sepse fëmijët vazhdimisht kanë nevojë për këto këshilla dhe udhëzime, sepse ata asnjëherë gjatë gjithë shkollimit të tyre nuk do të mësojnë këto gjëra derisa të regjistrojnë kursin për autoshkollë.

Muhamed Krasniqi,

shkolla e lartë profesionale "Tempulli",

Prishtinë